

VENDIM
Nr. 29, datë 8.5.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR
KRAHASUESHMËRINË E TARIFAVE TË LIDHURA ME LLOGARITË E
PAGESAVE DHE PËR SHËRBIMIN E TRANSFERIMIT TË LLOGARIVE TË
PAGESAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 53, pika 4, nenit 55, pika 1, shkronja “e”, të neneve 124 dhe 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”; dhe të nenit 8, pika 3, nenit 14 dhe nenit 22 të ligjit nr. 100/2023, datë 14.12.2023, “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 21.12.2022, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Neni 1 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Objekti i kësaj rregulloreje është:

a) përcaktimi i kërkesave për krahasueshmërinë dhe transparencën e tarifave që u ngarkohen konsumatorëve në llogaritë e tyre të pagesave dhe i kërkesave për transferimin e llogarive të pagesave ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave;

b) përcaktimi i kërkesave për krahasueshmërinë dhe transparencën e tarifave që u ngarkohen konsumatorëve në llogaritë e tyre të pagesave me shërbime bazike dhe i kërkesave për transferimin e llogarive të pagesave me shërbime bazike ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave; si dhe

c) përcaktimi i metodologjisë së përlllogaritjes së tarifës së arsyeshme për shërbimet e ofruara në llogarinë e pagesave me shërbime bazike.”;

b) Në nenin 2, pas togfjalëshit “ligjit nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave””, shtohet togfjalëshi “, si dhe bankat dhe degët e bankave të huaja, sipas ligjit nr. 100/2023 “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike””;

c) Neni 3, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 53, pika 4, nenit 55, pika 1, shkronja “e”, të neneve 124 dhe 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë ligji “Për bankat”); të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave” (më poshtë ligji “Për shërbimet e pagesave”) dhe të nenit 8, pika 3, nenit 14 dhe nenit 22 të ligjit nr. 100/2023, datë 14.12.2023, “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike” (më poshtë ligji “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”).”;

d) Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

i. Pika 1, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar sipas nenit 4 të ligjit “Për bankat”, nenit 5 të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe nenit 5 të ligjit “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike.”;

ii. në pikën 2, pas shkronjës “a”, shtohet shkronja “a/1” me përmbajtjen e mëposhtme:

“a/1) “llogari e pagesave me shërbime bazike” - do të ketë të njëjtin kuptim si në ligjin “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike.”;

iii. në pikën 2, shkronja “h”, togfjalëshi “në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar”, zëvendësohet me togfjalëshin “në pikën 18 të nenit 5 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”.”;

e) Pas nenit 16, shtohet “KREU IV” dhe nenet 17 dhe 18 si pjesë përbërëse e kreut IV, me përmbajtjen e mëposhtme:

“KREU IV

KËRKESA PËR LLOGARINË E PAGESAVE ME SHËRBIME BAZIKE

Neni 17

Krahasueshmëria, transparenca e tarifave dhe transferimi i llogarive të pagesave me shërbime bazike

Kërkesat e kreut I, II dhe III të kësaj rregulloreje për llogarinë e pagesave, zbatohen në të njëjtën mënyrë nga bankat, edhe për llogarinë e pagesave me shërbime bazike, në zbatim të kërkesave të nenit 14 të ligjit “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”.

Neni 18

Metodologjia e përlllogaritjes së tarifës së arsyeshme për shërbimet e ofruara në llogarinë e pagesave me shërbime bazike

Bankat, në përlllogaritjen e tarifës së arsyeshme për shërbimet e ofruara në llogarinë e pagesave me shërbime bazike, siç parashikohet në nenin 8, pika 3 të ligjit “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”, bazohen në nivelin mesatar të tarifës së aplikuar nga banka, për të njëjtat shërbime të ofruara nëpërmjet një llogarie pagesash dhe në çdo rast tarifa e arsyeshme nuk tejkalon 50% të këtij niveli mesatar.”;

- f) Kreu IV “Dispozita të fundit”, rinumërohet si kreu V;
- g) Neni 17 dhe neni 18, rinumërohen përkatësisht si neni 19 dhe neni 20;
- h) Në nenin 19 të rinumërtuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - i. titulli i nenit “Ankesat e klientëve”, zëvendësohet me titullin “Ankesat e konsumatorëve”;
 - ii. pas togfjalëshit “për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve”, shtohet togfjalëshi “, përfshirë edhe ankesat në lidhje me llogarinë e pagesave me shërbime bazike.”;
- i) Në nenin 20 të rinumërtuar, pas togfjalëshit “në ligjin “Për shërbimet e pagesave””, shtohet togfjalëshi “, në ligjin “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike””.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko